



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR
MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

Nr. 889 Prot.
Tiranë, më 08.06.2022

**DREJTORIA
E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS**

Nr. 1104/6 Prot.
Tiranë, më 08.06.2022

**KËSHILLI
I QARKUT
FIER**

Nr. 687/1 Prot.
Tiranë, më 09.06.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

1. **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** - (në vijim **KMD**), me seli në adresën: Rruga e "Durrësit", Nr. 27, Tiranë, është një person juridik publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, **përfaqësuar nga Komisioneri Z. Robert GAJDA**,
2. **Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas** – me seli në adresën: Rruga "Jordan Misja", Godina Nr. 3, Tiranë, është një person juridik publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", **përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Ergys Qirici**,
3. **Këshilli i Qarkut Fier** - me seli në adresën: Rruga "Ramiz Aranitasi" Nr. 15, Fier, i cili është një person juridik publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **përfaqësuar nga Kryetarja Znj. Evis Sema**.

DHE

Palët, bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si "**Marrëveshja**"), si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

Në Marrëveshje midis tyre, palët kanë bien dakord që brenda ambienteve të *Këshillit të Qarkut Fier* (në vijim *Këshilli*), Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, do t'i vihen në dispozicion 3 (tre) poste pune të dedikuara për ofrimin e shërbimeve në bazë të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

6. Kujdesen për mirëmbajtjen e ambienteve të marra në përdorim dhe sigurojnë bazën materiale të domosdoshme për funksionimin e zyrave të tyre dhe ofrimin e shërbimeve.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Këshillit të Qarkut Fier

Këshilli i Qarkut Fier merr përsipër që t'i vërë në dispozicion pa kundërshtpërblim, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi 1 (një) post pune dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas 2 (dy) poste pune, të aksesueshme nga publiku, brenda godinës së tij.

Neni 6

Punonjësi i KMD-së/Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, të drejtat dhe detyrimet e tij

1. Punonjësi i ngarkuar për ofrimin e shërbimeve në postin e punës të vënë në dispozicion, është nëpunës i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi/Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, i emëruar në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. Marrëdhënia e tij e punës mbetet në fuqi dhe nuk transferohet te Këshilli gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje.
3. Këshilli nuk ka detyrime financiare ndaj punonjësit të KMD-së/Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, i cili shërben në Zyrën e vendosur në hapësirat e Këshillit të Qarkut Fier.

Neni 7

Shpenzimet për funksionimin e Zyrës së KMD-së dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

1. Shpenzimet për funksionimin e Zyrës Rajonale Fier të KMD-së përballohen nga fondet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe shpenzimet për funksionimin e Zyrës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, përballohen nga kjo e fundit.
2. Shpenzimet e mbuluara nga KMD dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për Zyrat respektive, përfshijnë shpenzimet për pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësin, internetin dhe shpenzimet operative (bojë për pajisjet, letër, kancelari etj.) për mirëfunksionimin e zyrave.
3. Këshilli merr përsipër të sigurojë vënien në dispozicion të ambientit të punës ,një zyrë nëkatin 0 (zero),si dhe furnizimin e ambientit të punës me energji elektrike dhe ujit në ambientet e Këshillit të Qarkut .

Neni 8

Shkëmbimi i informacionit dhe i dokumentacionit

Proçesi i ofrimit të shërbimit në zyrat përkatëse do të bëhet në bazë të rregullimeve ligjore/nënligjore/kontraktuale në fuqi për ofrimin e shërbimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes do zgjidhet me diskutim dhe mirëkuptim midis palëve, në të kundërt do u nënshtrohet ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 11 Dispozita të fundit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u hartua në 6 (gjashtë) kopje me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe dhe secila palë mban 2 (dy) kopje të njëjta.

PALËT

PËR

KOMISIONERIN PËR
MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI

KOMISIONERI

Robert GAJDA




PËR

DREJTORINË E
NDIHMËS JURIDIKE
FALAS

DREJTORI

Ergys QIRICI



PËR

KËSHILLIN E
QARKUT
FIER

KRYETARE

Evis SEMA

